



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 421/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Synavere Rysha nga subjekti politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër Rezultatit Përfundimtar të Publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), më datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Synavere Rysha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, në ora 13:18 nga kandidatja për deputete për Kuvendin e Republikës së Kosovës- Synavere Rysha nga subjekti politik LDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se në Qendrën e Votimit QV 2501Y/08R përkatësisht në vendvotimin VV nr.08R, pra në Formularin e Rezultateve për Kandidatë nuk ju kanë shënuar 87 vota të saj në këtë vendvotim.

Parashtruesja e ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e komisioneres në QV 2501Y Hatixhe Avdullahut dhe kopjet e FRK-së në QV 2501 pra në VV08R.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë : *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme.”* Andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidatja për deputete – Synavere Rysha të subjektit politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidatja në fjalë pretendon

se në vendvotimin me nr.2501Y/08R, ka pasur 87 vota të cilat sipas parashtrueses së ankesës nuk janë shënuar në FRK.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2501Y/08R për komunën e Ferizajit e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 113781, 113784, 113783 dhe 113782, ndërsa shiriti i mesëm me numër 109186 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 109188. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 034341 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 051760, 051758, 151757, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-i ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR pas hapjes së kutive dhe numërimin e fletëvotimeve lidhur me kandidatën në fjalë rezulton se janë të shënuara 36 vota për kandidaten me nr.33 nga radhët e subjektit politik LDK dhe jo siç pretendohet në ankesën e saj se nuk posedon asnjë votë. Ndërsa në vendvotimin VV 2501Y/08DR rezulton se i ka 33 vota dhe e jo siç ka thekuar në ankesë se i ka 87 vota dhe 1 fletëvotim ka qenë i pavlefshëm sa i përket kandidatëve sepse kanë qenë të shënuara mbi 5 persona në pjesën ku votohet për kandidat. Nga ky numërim PZAP-i konstaton se kandidatja në fjalë lidhur me këtë vendvotim i posedon 36 fletëvotime të vlefshme e jo siç ka pretenduar në ankesën e saj se i posedon 87. Prandaj për këtë arsye edhe është hapur kutia e votimit për rastin në fjalë sepse votat e kandidatës të lartpërmendur kanë qenë të shënuar në FRK dhe të njëjtat janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të publikuara nga KQZ-ja.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 421/2014 më datën 30.06.2014



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*